



INSTITUTI I KURRIKULËS DHE I TRAJNIMIT

PROGRAM MËSIMOR PËR ARSIMIN FILLOR

LËNDA: GJUHË ITALIANE

(Klasa e pestë)

Tiranë, 2008

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

- I. HYRJE
- II. SYNIMET
- III. OBJEKTIVAT
 - PËRSHKRIMI I AFTËSIVE GJUHËSORE
 - AKTET / FUNKSIONET KOMUNIKATIVE
 - TEMATIKA
 - STRUKTURAT GRAMATIKORE
- IV. SHPËRNDARJA E ORËVE
- V. INTEGRIMI
- VI. METODOLOGJIA E ZBATIMIT TË PROGRAMIT
- VII. VLERËSIMI DHE VETËVLËRËSIMI
- VIII. SHTOJCË:
MODEL ORIENTUES I LIDHJES SË TEMËS, AFTËSIVE, AKTEVE
KOMUNIKATIVE, ELEMENTEVE GRAMATIKORE E LEKSIKORE

I. HYRJE

Ashtu si në dy klasat paraardhëse, edhe në klasën e pestë mësimi i gjuhës italiane si gjuhë e huaj do të vazhdojë të kryhet me 2 herë në javë, me një sasi të përgjithshme prej 70 orësh mësimore, të shtrira përgjatë gjithë vitit shkollor.

Synimet dhe objektivat didaktike të parashtruara në këtë program janë hartuar mbi bazën e atyre të programuara për klasat pararendëse (klasa III-IV), duke rimarrë e zgjeruar njohuritë dhe shprehitë e paraqitura më parë me synim përvetësimin dhe shprehizimin e tyre.

Kjo kurrikul, dhe për rrjedhojë i tërë kursi gjuhësor, kanë pasur parasysh moshën e nxënësve me karakteristikat moshore përkatëse; për këtë arsye në të paraqiten tematika, objektiva, akte apo funksione komunikative që lidhen me këtë moshë.

Struktura dhe përmbajtja e këtij programi u përmbahen gjerësisht rekomandimeve të Kurrikulës Kombëtare të Gjuhëve Moderne.

II. SYNIMET

Përfshirja dhe mësimdhënia e gjuhës italiane si gjuhë e huaj në planin mësimor të shkollës 9-vjeçare, krahas gjuhëve të tjera (anglisht, frengjisht), rrit mundësitë që shkolla jonë u ofron nxënësve për zhvillimin e kompetencës gjuhësore dhe të ndërgjegjësimit ndërkulturor të tyre dhe mund të konsiderohet si përgjigja e duhur ndaj politikave nxitëse të bashkimit evropian për formimin e qytetarit evropian.

Duke pasur parasysh se gjuha është:

- mjet i të menduarit (gjë që nënkupton kryerjen e operacioneve mendore);
 - mjet për të vendosur një marrëdhënie shoqërore (që nënkupton një bashkëveprim ndërmjet folësve);
 - mjet i shprehjes dhe trashëgimit të përvojës (që realizon një ndërveprim social-edukativ);
 - mjet i shprehjes së ndjenjave, gjendjes shpirtërore (që nënkupton dimensionin estetik të saj);
 - mjet për shprehjen e kulturës (që nënkupton dimensionin historik, shoqëror, mjedisor, etj),
- mësimdhënia/nxënia e gjuhës së huaj (italishtes) do të parashtronte këto synime, si më poshtë:

Mësimdhënia/nxënia e gjuhës italiane në shkollën 9-vjeçare ndihmon në formimin e përgjithshëm të nxënësit; zgjeron aftësitë e tij shprehëse; ofron modele të të sjellurit në situata të caktuara mësimore; ndihmon përfshirjen e nxënësit në shkëmbime të shumëllojshme.

Mësimi i gjuhës italiane si gjuhë e huaj njëkohësisht është dhe proces njohjeje i kulturës kombëtare si dhe i kulturës së popullit tjetër dhe, si i tillë, bën të mundur një zgjerim të aftësive formuese, kulturore dhe njohëse të personalitetit të nxënësit duke kontribuar kështu në mënyrë të drejtpërdrejtë në formimin e personalitetit të tij, në përfshirjen e tij në një ndërveprim socio-kulturor më të gjerë përmes marrëdhëniesh ndërpersonale dhe sociale.

Mësimdhënia e gjuhës italiane si gjuhë e huaj në shkollën 9-vjeçare synon zhvillimin e proceseve konjitive, trainimin e mendjes, krijimin e aftësive njohëse dhe krijuese; mbi të gjitha ajo synon t'i pajisë nxënësit me strategji individuale nxënëse (*way of learning*).

III OBJEKTIVAT E PROGRAMIT

1.Përshkrimi i aftësive gjuhësore (performanca gjuhësore)

Për secilën aftësi përcaktohen objektivat e të nxënësve. Këto aftësi janë të konceptuara brenda linjave dhe nënlinjave të mëposhtme:

Linja	Nënlinja
1.Komunikimi dhe formimi kulturor	a.Kultura dhe komunikimi
	b.Aktet dhe funksionet e komunikimit
2.Formimi gjuhësor	a.Elementet/strukturat gramatikore
	b.Tematika

Duke iu referuar kuadrin të përgjithshëm të Kurrikulës së Gjuhëve Moderne, performanca e përgjithshme e nxënësve të klasës së pestë fillore do të përshkruhet sipas standardeve të mëposhtme, të përshkruara sipas aftësive të veçanta.

Mësimnxënja e gjuhës italiane si gjuhë e huaj në këtë nivel shkollor, si edhe përdorimi i saj në mënyrë më të gjerë e më të plotë krahasuar me ciklin fillor, synon zhvillimin e aftësisë së të kuptuarit dhe të krijuarit, me shkrim dhe me gojë, përmes një shkëmbimi bashkëveprues në të katër aftësitë tradicionale: të dëgjuar, të lexuar, të folur e të shkruar, që finalizohen në:

a-zotërim të përmbytjes së teksteve të ndryshme (ky objektivi synon të zhvillojë aftësitë e të kuptuarit dhe të artikuluarit të gjuhës së shkruar dhe të folur);

b-përmirësim gradual të shprehjes gjuhësore (përmes një perceptimi të saktë të gjuhës së folur, një shqiptimi të pranueshëm, një leximi të rrjedhshëm dhe shprehës, një shkrimi korrekt edhe nga ana ortografike);

c-ndërgjegjësim gjithnjë në rritje lidhur me sistemin gjuhësor dhe me funksionimin e gjuhës; ky është një proces i vazhdueshëm i cili ecën përpara duke u përmirësuar vazhdimisht përgjatë jetës.

Objektivi kryesor është arritja nga ana e nxënësve në përfundim të kursit të aftësisë kuptimore dhe shprehëse kryesisht gojore, aftësi e cila do t'i lejojë atij të kryejë në gjuhën italiane funksionet komunikuese bazë të cilat i ndesh në situatat më të shpeshta të jetës së tij; situata të tilla u përkasin interesave dhe përvojës së moshës së nxënësve.

Të dëgjuarit

Në përfundim të klasës së pestë, nxënësi:

-kupton një ligjërim të shkurtër gojor nëse ai është i artikuluar me kujdes dhe përmban pauza që bëjnë të mundur nxjerrjen e kuptimit;

-kupton fraza dhe shprehje që lidhen me fushat prioritare (p.sh. informacione të thjeshta rreth familjes, psonisjes, gjeografisë së vendit, shkollës, etj.);

- kupton aq sa të përballojë nevojat imediate me karakter konkret nëse ligjërimi është i artikuluar ngadalë dhe qartë;
- kupton dhe ndjek udhëzime të shqiptuara ngadalë;
- kupton udhëzime të thjeshta që kanë të bëjnë me mënyrën për të shkuar nga një vend x në një vend y , në këmbë apo me mjete të transportit publik;
- nxjerr thelbin në mesazhe dhe njoftime të shkurtra;

Tekste:

- dialogje* që kanë të bëjnë me:
 - situata në familje,
 - situata në mjedisin shkollor,
 - situata me lojrat dhe kohën e lirë,
 - situata në një mjedis publik si dyqan, etj.,
 - informacione mbi shkollën,
 - informacione mbi bibliotekën, librat,
 - shenjat e qarkullimit rrugor apo të transportit publik,
- monologje* që kanë të bëjnë me:
 - lajmërimet shkollorë të shkurtra,
 - lajmërimet të shkurtra radio-televizive,
 - mesazhe të shkurtër e të thjeshtë.

Të folurit

- Në përfundim të klasës së pestë, nxënësi:
 - u përgjigjet pyetjeve të thjeshta e të drejtpërdrejta, të shqiptuara qartazi dhe ngadalë, të ndërtuara me një gjuhë të drejtpërdrejtë dhe jo idiomatike, për çështje personale;
 - u përgjigjet pyetjeve të thjeshta dhe reagon ndaj pohimesh të thjeshta gjatë një interviste;
 - di të bëjë një përshkrim të thjeshtë të njerëzve, rrethanave jetësore, veprimtarisë së përditshme, të asaj që i pëlqen apo jo, me fjali të thjeshta e të shkurtra;
 - ndërvepron në mënyrë të thjeshtë në komunikime të përditshme nëse frazat përsëriten më ngadalë, riformulohen apo dhe korrigjohen;
 - bën pyetje të thjeshta dhe përgjigjet, merr iniciativën në të folur dhe u reagon ndaj pohimesh të thjeshta që lidhen me nevoja imediate apo me çështje shumë të njohura për të;
 - komunikon në aktivitete të thjeshta në të cilat kërkohet një shkëmbim i thjeshtë informacioni rreth çështjesh të njohura që lidhen me familjen, shkollën, lojën dhe kohën e lirë;
 - bën pyetje dhe përgjigjet për çështje që kanë të bëjnë me veten e tij apo me të tjerët (mjedisi ku jeton, njerëzit që njeh, gjërat që zotëron);
 - pyet dhe u përgjigjet pyetjeve të thjeshta, bën apo u reagon ndaj pohimesh të thjeshta mbi çështje të njohura apo që i shërbejnë për të përmbushur nevoja imediate;
 - pyet të tjerët për shëndetin dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj informacioneve që i jepen;

- prezanton veten dhe të tjerët dhe përdor shprehje të thjeshta përshëndetëse tipike për takim/ndarjet;
- shpreh pëlqim apo mospëlqim ndaj diçkaje;
- kërkon e jep diçka;
- pyet për të marrë dhe dhënë gjëra njëri-tjetrit;
- kërkon apo porosit diçka për të ngrënë apo për të pirë;
- bën psonisje gjërash të thjeshta duke treguar çka don dhe duke pyetur për çmimin;
- jep dhe merr informacione rreth sasisë, numrave, çmimeve;
- përfton informacione të shkurtra lidhur me përdorimin e mjeteve të transportit publik (autobus, tren), pyet dhe jep të dhëna, blen biletat;

Tekste:

monologje në të cilat:

- di të prezantojë dhe të flasë mbi veten;
- përshkruan familjen e vet;
- flet për një mik;
- përshkruan vendin e tij;
- flet për mësimet;
- flet për kohën e lirë;
- flet për zakonet e tij;
- përshkruan një përvojë të caktuar;

bashkëveprim me mësuesin për tema të përshkruara në monologje;

role-play shumë të thjeshtë në të cilët riprodhohen situata në një dyqan, lokal, shkollë, bibliotekë, stacion, etj.

Të lexuarit

Në përfundim të klasës së pestë, nxënësi:

- lexon e kupton fjalë, fraza dhe tekste të shkurtër, dialogje të thjeshtë, të studiuar apo të njohur më parë;
- kupton tekste shumë të shkurtër, shumë të thjeshtë, që përmbajnë një fjalor shumë të përdorshëm, duke dalluar emra, fjalë e fraza bazë, përmes edhe rileximit nëse është e nevojshme;
- kupton tekste shumë të thjeshtë dhe të shkurtër që trajtojnë çështje të llojit konkret me një gjuhë të përditshme e me përdorim të gjerë që lidhen me situatën shkollore apo me situata të tjera të njohura për të;
- kupton tekste të thjeshtë dialogjike shoqëruar me figura apo vizatime;
- kupton mesazhe të shkurtër, të thjeshtë të shkruar në kartolina apo mesazhe sms në celular apo në postë elektronike;
- dallon emra, fjalë dhe fraza të njohura në tekste që lidhen me situatat e përditshme e të zakonshme;
- gjen informacion në materiale me përdorim të përditshëm shkollore, si lajmërimi, detyra, orari, etj;
- ndjek udhëzime të shkruara shkurt dhe thjesht;
- kupton udhëzime të thjeshta për lojrat apo për garat e ndryshme të moshës;
- kupton tregime dhe përshkrime shumë të shkurtra e të thjeshta në të cilat është përdorur e tashmja, e kaluara dhe e ardhmja;

Tekste:

kartolina,
mesazhe në internet,
mesazhe me telefon celular;
fletëpalosje,
tabela apo reklama,
lajmërimë për fëmijë (mbi me koleksione sendesh, lojra, etj.),
udhëzime të thjeshta (rregullat e një loje, etj.),
paralajmërimë rreziku,
orare (shkolle, mjete të transportit, mjedisesh sportive, etj.),
histori të shkurtra me figura.

Të shkruarit

Në përfundim të klasës së pestë, nxënësi:

- shkruan fjalë e fraza të veçuara;
- shkruan një sërë frazash të thjeshta të lidhura me lidhëzat *e, ma, perchë*;
- shkruan fraza të thjeshta mbi vetveten apo mbi persona të tjerë, ku banojnë, çfarë bëjnë, etj;
- kërkon dhe jep informacione vetjake me shkrim;
- shkruan kartolina të thjeshta, mesazhe të thjeshtë sms në celular apo në postë elektronike;
- shkruan numra, data, emrin, kombësinë, adresën, moshën, datëlindjen, në formularë apo në skeda me të dhëna vetjake;
- përshkruan njerëz, vende, veprimtari të përditshme, atë që i pëlqen apo jo, përmes frazash të thjeshta edhe të shkëputura njëra nga tjetra;
- përshkruan vetveten, ku banon dhe çfarë bën;
- përshkruan familjen e vet, mjedisin shkollor, etj.

Tekste:

module apo formularë (shkolle, biblioteke, etj.),
kartolina,
mesazhe poste elektronike apo në telefon celular,
lajmërimë në një kënd lajmërimesh apo në gazeta për fëmijë,
histori me figura.

2. Tematika dhe leksiku

a. Tematika

Rimerren pjesa më e madhe e temave dhe çështjeve të trajtuara në dy nivelet pararendëse (klasa III-IV) të cilat lidhen me interesat dhe nevojat e kësaj moshe, në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia e përmbajtjes por në formë më të zgjeruar.

1. JETA E PËRDITSHME

familja, të afërmit, marrëdhëniet familjare, ndarja e detyrave në familje;
kafshët shtëpiake;
festat familjare;
shokët dhe shoqet e lagjes a mëhallës;
koha e lirë dhe hobet;
ditët, muajt, datat, orët;
shtëpia, mjediset e brendshme, objektet apo sendet në të, llojet e banesave;
guzhina, ushqime dhe pije (ndonjë veçori e kuzhinës shqiptare dhe italiane);

2. JETA SHKOLLORE

shkolla, klasa, objektet përreth, orari;
shokët dhe shoqet e grupit, marrëdhëniet me ta;
personeli i shkollës;
lëndët mësimore dhe preferencat lëndore;
përcaktimi i veprimtarive (lexim, shkrim);
librat dhe biblioteka;
numrat dhe veprimet aritmetike;

3. VETJA DHE TË TJERËT

shëndeti, sëmundjet;
trupi, higjiena;
mënyra e të veshurit, prirjet;
tipare fizike;
karakteristika të shokëve apo dhe të popujve të tjerë;
popujt dhe pamja e tyre e jashtme (momente ndërkulturore);
miqësi të reja;

4. MJEDISI RRETHUES

qyteti, shtetet, kontinentet;
koha, moti, stinët, klima;
adresa, mjetet e transportit e të telekomunikacionit;
udhëtimet e bëra apo që dëshirohet të bëhen;
vende takimi dhe argëtimi, monumente arti e historike;
monedha, dyqane, tregu;
zyrat publike;

5.BOTA TELEMATIKE

programe radio-televizive të ndjekura; herojtë dhe personazhet;
korrespondenca elektronike me miqtë;

6.LOJRAT DHE SPORTI

lojrat, sporti i preferuar;
lojrat dimërore dhe verore;
veshjet sportive;

7.TREGIME, PËRRALLA, FABULA, GJEAGJËZA DHE KËNGË TË MOSHËS

b. Leksiku

Përzgjedhja e teksteve bazohet mbi një repertor leksikor prej afro 400 fjalësh, prej të cilave 250 bëjnë pjesë në fjalorin bazë të gjuhës italiane, ndërsa 150 të tjerat lidhen me fusha dhe kontekste përdorimi të veçanta për moshën. Nëpër tekste mund të përfshihen edhe një përqindje fjalësh që nuk i përkasin fjalorit bazë por që kuptimi i tyre nxirret lehtësisht nga konteksti.

3. Aktet / funksionet e komunikimit

Duke patur parasysh moshën e nxënësve, nevojat e tyre komunikative si edhe synimet edukative të sistemit arsimor shqiptar, rimerren edhe në këtë klasë një sërë aktesh apo funksionesh komunikative të cilat, për nga pesha dhe për nga shkalla e përdorimit, janë ndër më të rëndësishmet; atyre u përgjigjet një strukturë gramatikore dhe një fushë e caktuar semantiko-leksikore:

Takojnë dikë e njihen me të

- prezantohen e i përgjigjen një prezantimi
- prezantojnë persona të tjerë
- kërkojnë e përgjigjen për emrin dhe mbiemrin
- kërkojnë e thonë prej nga vijnë
- kërkojnë e përgjigjen si shkruhet një fjalë
- kërkojnë e përgjigjen për kombësinë
- kërkojnë e përgjigjen për moshën
- kërkojnë e përgjigjen për numrin e telefonit
- kërkojnë e përgjigjen për adresën e banimit apo të një vendi tjetër
- kërkojnë e përgjigjen për profesionin;

Marrin pjesë në një bisedë me karakter të përgjithshëm

- përhëndetin e u përgjigjen përshëndetjeve
- kërkojnë e përgjigjen për orën
- falenderojnë e u përgjigjen falenderimeve
- kërkojnë e japin informacione mbi shëndetin
- tregojnë objekte dhe persona
- kërkojnë dhe ofrojnë objekte, i pranojnë apo i refuzojnë ato
- kërkojnë e japin informacione shumë të thjeshta rreth personash, objektesh dhe vendesh
- bëjnë ftesa, i pranojnë apo i refuzojnë ato
- kërkojnë e përgjigjen për çka dinë të bëjnë (gjuhët, sportet, etj.)
- kërkojnë leje, e pranojnë apo e refuzojnë atë
- bëjnë propozime, i pranojnë apo i refuzojnë ato
- shprehin habi, admirim përmes pasthirmash
- shprehin kënaqësi apo moskënaqësi
- kërkojnë e japin informacione mbi kohën
- shprehin qëllime apo synime
- shprehin ndjenjën e frikës, të druajtjes apo të shpresës
- kërkojnë e thonë datën
- tregojnë fakte të thjeshta në të tashmen, të shkuarën dhe të ardhmen
- kërkojnë e shprehin opinione të thjeshta për persona, sende, vende apo ngjarje
- bëjnë krahasime
- shprehin pëlqim apo mospëlqim
- bëjnë deduksione të thjeshta
- shprehin nevoja apo dëshira

Marrin pjesë aktive në një ndërveprim në mjedis publik

- tërheqin vëmendjen e dikujt
- kërkojnë e thonë vendndodhjen e objekteve të ndryshëm
- kërkojnë e japin udhëzime për rrugën apo adresën
- kërkojnë për një mall apo send në dyqan a gjetkë
- pyesin për çmimin dhe vlerën
- porositin

Përdorin mjetet e komunikimit

- hapin e mbyllin një bisedë telefonike
- shkruajnë mesazhe të shkurtër personale si edhe letra të thjeshta me karakter informal.

Njohin e përdorin mjetet e transportit

- njohin e përshkruajnë funksionin e mjeteve më të rëndësishme të transportit
- njohin e përshkruajnë funksionet më të rëndësishme të sinjaleve rrugore.

4. Elemente dhe struktura gramatikore

a- Morfosintaksa

Strukturat e parashikuara synojnë të nxisin aftësinë komunikuese të nxënësve duke aktivizuar funksionet komunikative minimale. Këto janë strukturat më të përdorshme që bëjnë të mundur realizimin e komunikimit në një nivel minimal brenda fushës tematike që përcakton kjo moshë.

Niveli i nxënësve presupozon zotërimin e këtyre strukturave morfosintaksore:

- 1) Nyjet shquese dhe joshquese;
- 2) gjinia dhe numri i emrave të rregullt;
- 3) mbiemrat cilësorë dhe shkallët e krahasimit të tyre;
- 4) zgjedhimi vepror i foljeve ndihmëse *essere* dhe *avere* si edhe i foljeve të rregullta në mënyrat dhe kohët e mëposhtme:
 - presente indicativo
 - passato prossimo
 - urdhërore (forma veprore dhe mohuese në v. 2⁰ njejës dhe shumës)
- 5) foljet modale *potere*, *dovere*, *volere*;
- 6) përemrat vetorë kryefjalorë;
- 7) ndajfoljet kryesore -të kohës, të vendit, apo të tjera mjaft të përdorshme;
- 8) numërorët themelorë nga 1 në 20, dhjetëshe (20, 30, 40, etj.), qindëshe, mijëshe, numërorët rreshtorë nga 1⁰ në 10⁰;
- 9) parafjalë të thjeshta dhe të përbëra;
- 10) fraza e thjeshtë: fjali dëftore, pyetëse (të paraprirë nga *chi*, *come*, *dove*, *quando*, *perchè*, *che cosa*), urdhërore;
- 11) fraza e thjeshtë me bashkërenditje me lidhëzat *ma* dhe *e*;
- 12) pasthirrma të ndryshme

b. Fonologjia

Gjuha e paraqitur është ajo që flitet rregullisht në komunikimin e përditshëm, pa nuanca krahinore. Nxënësi arrin të njohë intonacionin pyetës, dëftor apo urdhëror, kundërvënien e disa fonemave të thjeshta/dyshe.

IV. SHPËRNDARJA E ORËVE (Struktura sintetike e programit)

35 javë x 2 orë = 70 orë

Paraqitje njohurish të reja, veprimtari ushtruese, përforcuese, rimarrëse:	52 orë
Veprimtari përsëritëse / rikapitulluese:	4 orë
Veprimtari verifikuese / kontrolluese të njohurive dhe të aftësive:	4 orë
Veprimtari të ndryshme të lira:	10 orë
<i>Gjithsej:</i>	70 orë

Paraqitje njohurish të reja, veprimtari ushtruese, përforcuese, rimarrëse (52 orë). Në kuadrin e garantimit të autonomisë së mësuesit në mësimdhënie, ky është i lirë që të planifikojë vetë mësimin, numrin e orëve që nevojiten për secilën njësi didaktike në varësi të nivelit të nxënësve me të cilët punon.

Veprimtari përsëritëse / rikapitulluese (4 orë). Gjatë përsëritjes së njohurive të fituara deri në atë pikë, të synohet rifreskimi i njohurive, funksioneve, nocioneve e strukturave më të rëndësishme si dhe përdorimi i tyre në situata të tjera.

Veprimtari verifikuese / kontrolluese të njohurive dhe të aftësive: (4 orë). Me këtë veprimtari, me shkrim, nuk synohet vetëm vlerësimi i thjeshtë i njohurive, por edhe njëfarë ndërgjegjësimi paraprak i nxënësit për rezultatin e punës dhe të arritjeve individuale, çka do t'i shërbente motivimit të për të vazhduar procesin e të nxënësve gjuhësor.

Veprimtari të ndryshme të lira (10 orë). Kjo sasi orësh i lihet në dispozicion nismës dhe planeve që mësuesi dhe shkolla kanë në funksione të përmbushjes dhe realizimit sa më të mirë të nevojave dhe interesave të nxënësve dhe të komunitetit, në përputhje me këtë program dhe me Udhëzimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës Nr. 38, dt. 9.10.2007 për orët e lira.

Veprimtaritë e orëve të lira planifikohen hap pas hapi midis mësuesve të lëndës, mësuesve të gjuhës/gjuhëve të huaja, në bashkëpunim edhe me mësues të lëndëve të tjera; gjatë tyre, duhet të organizohen veprimtari që nxisin dhe zhvillojnë motivimin, argëtimin, rritjen intelektuale të nxënësit, frymën e bashkëpunimit përmes punës në grupe/skuadra, etj.

Si veprimtari që mund të zhvillohen gjatë orëve të lira, sugjerojmë organizimin e konkurseve brenda/midis klasës/klasave për tematika të ndryshme; dramatizime pjesësh, recitime tekstesh të përshtashme poetike, interpretim këngësh a lojrash muzikore, etj.

Këto veprimtari duhet të jenë të harmonizuara dhe të shtrira përgjatë vitit shkollor, larg monotonisë, rutinës dhe keqpërdorimit.

V. INTEGRIMI

Programi i gjuhës italiane për klasën e pestë mbështetet në integrimin ndërlëndor, duke e shfrytëzuar atë për aftësimin në rritje të nxënësve në përdorimin e njohurive gjuhësore në përgjithësi dhe të të katër aftësive (të dëgjuarit, të lexuarit, të folurit e të shkruarit).

Konceptet e njohuritë gjuhësore trajtohen e mësohen më mirë në kontekste të caktuara kuptimore, të cilat lidhen ngushtë me fusha tematike të parashtruara në programin e gjuhës italiane dhe të trajtuara në lëndët e tjera.

Trajtimi ndërlëndor i shërben synimeve të përgjithëshme të programit, si dhe realizimit të objektivave të linjave dhe nënlinjave të tij.

VI. METODOLOGJIA E ZBATIMIT TË PROGRAMIT

Një premisë me karakter metodologjik lidhet me parimin sipas të cilit nuk mund të realizohet të nxënit pa pjesëmarrjen aktive të nxënësit. Për të nxitur këtë pjesëmarrje duhen përdorur veprimtari në të cilat të ndërfutet sa më shumë të jetë e mundur nxënësi. P.sh. për të zhvilluar bisedën, do të ishte më mirë që në vend që të përdoshin figurat apo vizatimet e librit, të bëhej referim konkret tek sendet e pranishme në klasë, apo t'u kërkohej vetë nxënësve që të sillnin nga shtëpia disa sende apo objekte që lidhen me temën përkatëse.

Për të ngjallur motivimin dhe pjesëmarrjen e nxënësve duhen përdorur sa më gjerësisht teknikat e dramatizimit, role-play, etj., të cilat bëjnë të mundur një përfshirje fizike dhe emotive nxënësit në veprimtari në grup dhe i krijon mundësi atij të 'dalë jashtë' mjedisit shkollor, duke shkarkuar tensione, frustrime e duke shmangur filtrin afektiv bllokues, si edhe të nxjerrë në pah personalitetin e vet. Dramatizimi e role-play i krijojnë mundësi pjesëmarrje përmes dialogjeve në shkëmbime me karakter komunikues të cilat lypin kryerjen e një roli të caktuar në një mjedis të përcaktuar; ato bëjnë të mundur përdorimin e disa kanaleve shprehëse për komunikimin: gjuhën, veprimin, gjestin.

Me qëllimin për t'i nxitur nxënësit të shprehen, të komunikojnë duke zhvilluar dhe duke ushtruar aftësitë e tyre potenciale, është e nevojshme kryerja e veprimtarive shprehëse-krijuese-reflektuese-analizuese; për këtë nevojitet:

së pari, t'u jepet nxënësve një input më i zgjeruar, nocione dhe njohuri të reja, më të zgjeruara, më të plota e më të thella se ato të ciklit fillor;

së dyti, të nxiten nxënësit të reflektojnë për materialin didaktiko-edukativ që u jepet;

së treti, të nxiten ata të diskutojnë, të debatojnë (përmes përdorimit të gjuhës së huaj); si garanci për të arritur suksesin në punën tonë si mësues do të shërbejë pjesëmarrja e nxënësve në veprimtari komunikative, në shkëmbime, të cilat çojnë më pas në rritjen e motivimit dhe në nxitjen e të shprehurit, prej nga kalohet drejt një procesi analize, pjekurie dhe mendimi kritik nga ana e nxënësve.

Për shpjegimet e ndryshme si edhe për paraqitjen e veprimtarive praktike, mësuesi duhet të përdorë një gjuhë të qartë e të kuptueshme, një ritëm të shprehuri të ngadaltë, një shqiptim të dallueshëm.

Gjatë veprimtarive në klasë, mësuesi duhet të përpiqet të përdorë sa më shumë që të jetë e mundur gjuhën italishte; sidoqoftë, për të shmangur raste moskuptimi që nuk do të lejonin zhvillimin e një veprimtarie të caktuar në mënyrën e duhur, do të përdoret edhe gjuha amtare.

Pas paraqitjes së veprimtarisë apo lojës, të fjalëve apo strukturave të reja, mësuesi, nga roli fillimisht i aktorit duhet të mënjanohet e të kalojë në atë të regjizorit që drejton aktorët (nxënësit) duke i nxitur ato e duke dhënë *input*-e apo skena të reja.

Gjuha e përdorur në klasë është ajo bashkëkohore, në formën, ritmin dhe intonacionin e vet autentik.

Llojshmëria e teknikave didaktike do të bëjë të mundur që të gjithë nxënësit të përfitojnë duke patur parasysh faktin se aftësitë e tyre nuk janë të njëjta apo të barabarta. Lipset puna me grupe apo skuadra apo çifte në brendësi të të cilave të mos lejohet monopolizimi vetëm nga ana e 1-2 më të mirëve por t'u jepet mundësia të gjithëve të marrin pjesë: mësuesi i nxit të gjithë që të shprehen lirisht.

Reflektimi gjuhësor duhet të jetë:

- induktiv dhe konkret: është nxënësi ai që, duke ndjekur mënyrën induktive, zbulon rregullën përmes veprimtarish konkrete gjuhësore;
- i paraqitur në formë loje apo problemi për zgjidhje, i tillë që të nxisë nxënësit të vënë në përdorim aftësitë e veta vëzhguese;
- jo i bazuar mbi një metodologji të përqëndruar në shpjegimin e rregullës nga mësuesi, por që synon në zbulimin e saj nga vetë nxënësit natyrisht i ndihmuar edhe nga mësuesi.

Vëzhgimet sistematike të kryera nga ana e mësuesve gjatë procesit mësimor përbëjnë një mjet të favorshëm për përmirësimin e vazhdueshëm të programimit, duke u dhënë mundësinë mësuesve që të përfshijnë në kohën dhe vendin e duhur ato përmirësime apo plotësime që ata i gjykojnë të nevojshme. Kur niveli i nxënësve të klasës së pestë, për arsye e shkaqe të ndryshme, rezulton më i lartë se ai i përcaktuar në këtë kurrikul, atëherë, për të mos shkaktuar demotivim, si edhe për të shmangur monotoninë, mësuesi mund të propozojë e t'u paraqesë nxënësve të tij materiale të tjera gjuhësore, të zgjedhura e të përgatitura nga vetë ai, duke i integruar me materialin e tekstit të gatshëm, duke ndjekur sugjerimet e mëposhtme:

- të garantojë natyrshmërinë e gjuhës së paraqitur;
- të garantojë përshtatshmërinë e gjuhës me situatën dialogjike;
- të kufizojë strukturat dhe leksikun e ri të paraqitur
- të ketë parasysh që gjatësia e tekstit të ofruar të jetë e mjaftueshme për kontekstualizimin e formave të reja që të bëhet kështu i mundur një kuptim dhe një dramatizim i thjeshtë i tekstit;
- të paraqesë një farë shkalle interesi për nxënësit;
- të përdorë mjete vizive ndihmëse (objekte, pamje, fotografi, revista, etj. kur i mungojnë aparatat tv) të cilët e bëjnë të qartë kontekstin e dialogut dhe e lehtësojnë kuptimin global të materialit të paraqitur;

Në marrëdhëniet e mësuesit me grupin janë është thelbësore për ecurinë dhe suksesin e procesit vendosja e një klime e qetë bashkëpunimi nxënës-nxënës dhe nxënës-mësues: kjo klimë besimi dhe respekti reciprok vendoset përmes komunikimit të vazhdueshëm për të njohur interesat, problemet, nevojat dhe vështirësitë. Mësuesi duhet të mos kritikojë mospjekjet e nxënësve të vet, gabimet t'i konsiderojë si një fazë e pashmangshme dhe kalimtare të procesit të nxënies duke ndërhyrë vetëm në momente të përshtatshme e duke bërë përgjithësime kur

është e mundur por pa ndërprerë fluksin komunikativ; duhen nxitur e inkurajuar përpjekjet e nxënësve për t'u shprehur në gjuhën italiane.

Edhe gjatë klasës së pestë qasja didaktike do të jetë kryesisht gojore për të shmangur vështirësitë që lidhen me shqiptimin dhe grafinë e fjalëve apo frazave në italisht. Më pas, kur nxënësit tregojnë se e kanë asimiluar shqiptimin e teksteve gojore të dhëna, kalohet në fazën e leximit e cila do të konsistojë kryesisht në paraqitjen në formë të shkruar të teksteve të njohura me gojë. Nga leximi mund të kalohet më tej në veprimtari kopjuese apo rishkruese të fjalëve të veçanta me gjurmë, duke mbushur vendet bosh brenda fjalës apo brenda frazave të njohura më parë.

VII. VLERËSIMI DHE VETËVLERËSIMI

Me synimin për të siguruar një vlerësim efektiv të procesit mësimor, të pikënisjes dhe të pikëmbërritjes, të vështirësive të hasura si edhe të masave të ndërmarra, mësuesit duhet të mbledhin në mënyrë sistematike dhe të vazhdueshme informacion lidhur me zhvillimin dhe asimilimin e njohurive dhe aftësive, lidhur me gatishmërinë ndaj të nxënës, lidhur me shkallën e ndërgjegjësimit për çdo nxënës.

Mbi bazën e qasjes glotodidaktike të përdorur, edhe faza e verifikimit të arritjes së objektivave dhe e vlerësimit të aftësive përqendrohet mbi të kuptuarit dhe të prodhuarit gojor, duke mos neglizhuar natyrisht gjuhën e shkruar.

Informacionet duhet të mblidhen në mënyrë sintetike në mënyrë të atillë që të bëjnë të mundur një ballafaqim të nivelit të përparimit individual dhe kolektiv, në përputhje me natyrën e veprimtarisë së marrë në shqyrtim: p.sh., aftësitë me shkrim duhet të vlerësohen përmes veprimtarive të tilla si: shkrimi i fjalëve të veçuara apo frazave të shkurtra, plotësimi i vendeve bosh brenda fjalëve apo frazave të shkurtra, përmes batutave të shpeshta në një dialog të shkurtër, mesazheve të urimit, listave të thjeshta me emra rrobesh, ushqimesh, sendes të klasës apo të shtëpisë, etj.

SHTOJCË. Këtu më poshtë jepet një shembull modeli praktik, si orientim, se si mund të gërshetohen elementet përbërëse të programit (aftësitë, objektivat/standardet, tematika/ elementet gjuhësore/gramatikore)

TË DËGJUARIT

Përshkrimi i nivelit:	Tema	Akti i komunikimit	Tema dhe funksioni	Gjuha dhe struktura
Nxënësit shprehin kuptimin duke reaguuar ndaj përshkrimeve kryesore të mikrokonteksteve ose rrëfimeve bazë me ndonjë përsëritje.	Bota e komunikimit dhe teknologjisë. Tema: Telefoni dhe të folurit në telefon.	Marrin ose lënë një mesazh të thjeshtë telefonik.	Të folurit në telefon. Marrin në telefon, shënojnë emrin, kohën, numrin.	Marrin hollësitë kryesore të një mesazhi telefonik “Më quajnë...”, “Do të telefonoj prapë më...”, “Numri im është...”

TË FOLURIT

Përshkrimi i nivelit:	Tema	Akti i komunikimit	Tema dhe funksioni	Gjuha dhe struktura
Nxënësit japin përgjigje të shkurtëra për ato ç’ka shohin dhe dëgjojnë duke përdorur fraza të shkurtra për të shprehur dëshirat, ndjenjat, parapëlqimet .	Veprimtaritë e përditshme. Tema: Koha e lirë, kafshët shtëpiake, interesat.	Kopjojnë dhe shprehin dëshirat, parapëlqimet.	Koha e lirë, kafshët shtëpiake, interesat. Shprehin dëshirat.	“Ç’është ky/ai?” “Ai është...” “Ata janë”. Ju përgjigjen pyetjeve, luajnë role.

TË LEXUARIT

Përshkrimi i nivelit:	Tema	Akti i komunikimit	Tema dhe funksioni	Gjuha dhe struktura
Nxënësit shpalosin fillesat e leximit të pavarur, përdorin kontekstin për të interpretuar kuptimin dhe shprehin reagimin personal ndaj leximit.	Bota rreth nesh. Tema: Shtëpia dhe stre-himi.	Kuptojnë dhe reagojnë ndaj teksteve të thjeshta përshkruese.	Shtëpia dhe strehimi. Lexojnë dhe reagojnë ndaj përshkrimit të shtë-pisë së tyre, me shkrim.	Përzgjedhin dhe nxjerrin informacion nga teksti, kontrollojnë saktësinë.

TË SHKRUARIT

Përshkrimi i nivelit:	Tema	Akti i komunikimit	Tema dhe funksioni	Gjuha dhe struktura
Nxënësit shkruajnë fjali të shkurtra që ndërtohen me fjalë të thjeshta përshkruese dhe shprehin ndjenjat me shkrim.	Jeta personale dhe shoqërore. Tema: Njerëzit e tjerë.	Përshkruajnë shokët përmes portretizimit me shkrim të karakterit.	Njerëzit e tjerë. Shkruajnë disa fjali për të përcjellë informacion faktik.	Plotësojnë një përshkrim personal duke përdorur një model.

